

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti për Krime të Rënda, trupë gjykues i përbërë nga gjyqtari Skender Çoçaj kryetar, Artan Sejrani dhe Fatmir Krasniqi anëtarë, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Birsën Kume, duke vendosur në lëndën penale ndaj të akuzuarve K.G. nga fshati M...Komuna e F..., H. Sh. nga P..., N. B. nga fshati S. Komuna e F... dhe A. R. nga fshati D..., Komuna V..., për shkak se kanë kryer veprën penale të grabitjes në bashkëkryerje nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 31 të KP-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda, PP.nr.176/2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prezencë të Prokurorit të Shtetit Mehdi Sefa, të akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre Av. R. H., Av.B. B., Av.B. N. dhe Av. B.M., më datë 17.10.2017 mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

**1. K.G.**, nga i ati H. dhe e ëma R., e vajzërisë Q., i lindur me datën 06.10.1989, në P., tani banon në fshatin M..., Komuna e F... ka të kryer shkollën e mesme, bujk, i gjendjes së dobët ekonomike, i martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**2. H.SH.**, nga i ati N., dhe e ëma S., e vajzërisë H., i lindur më 14.07.1987 në P..., ku edhe tani banon në rr. "...'' nr..., ka të kryer shkollën fillore, moler, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, i ati i dy fëmijëve, i pa punë, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**3. N. B.**, nga i ati Sh. dhe e ëma F., e vajzërisë B., i lindur me 15.10.1984 fshatin S..., Komuna e F..., ku edhe tani banon, ka të kryer shkollën fillore, bujk, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar, i ati i tre fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**4. A.R.**nga i ati R. dhe e ëma Gj., e vajzërisë H., i lindur me 26.12.1989 në V..., tani jeton në fshatin D..., Komuna V..., i martuar, ka të kryer shkollën e mesme, me profesion zdrukthëtar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Në bazë të nenit 364 paragrafi 1 pika 1.3 të KPP-së.

### LIROHEN NGA AKUZA

Të akuzuarit: K. G., H. Sh., N. B. dhe A. R.

Se më 01.02.2015 rreth orës 04:38 min, në rrugën "...'' në P...në kazinon "...''", të akuzuarit me përdorim të forcës apo të kanosjes serioze për të sulmuar jetën apo trupin e personave V. K. dhe Sh. Th., përvetësojnë pasurinë e luajtshme të V. dhe Sh. me qëllim të sjellin vetes dobi pasurore të kundërligjshme në atë mënyrë që maskohen, armatosen me pistoletë, ku i akuzuari K. G. dhe A. R. bëjnë roje në hyrje të lokalit, ndërsa të akuzuarit N. B. dhe H. Sh.hyjnë brenda në kazino dhe në kërcënimin e armës i marrin të hollat 305

euro dhe kuletën punëtorit në kazino, kamarierit V. K., ndërsa Sh. Th. po ashtu ia marrin kuletën në të cilën ka pasur 69 euro dhe pastaj largohen në drejtim të panjohur nga vendi i ngjarjes.

Këso dore do të kryenin veprën penale të grabitjes në bashkëkryerje nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Për shkak se nuk është provuar se të akuzuarit në bashkëkryerje kanë kryer këtë veprë penale për të cilën akuzohen.

Të dëmtuarit Sh.Th. dhe V. K. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prizren, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar Aktakuzën me numër te rastit, PP.nr. ..., të datës 31.03.2017 kundër të akuzuarve K.G., H. Sh., N. B. dhe A. R. për shkak të veprës penale të grabitjes në bashkëkryerje nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 31 të KP-së. Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës ndaj të akuzuarve të lartcekur, për veprën penale të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës, me që me provat e administruara nga trupi gjykues, deklaratat e të dëmtuarve në cilësi të dëshmitarëve V.K. dhe Sh. Th.si dhe nga video inqizimet e marra të grabitjes së kazinos “...” në P... në rrugën “...”, ku me një qartësi shihet se personat e armatosur dhe të maskuar me datë 01.02.2015 në periudhën kohore 04:38, 05:38 minuta, me armë dhe në mënyrë të kundërligjshme kanë përvetësuar të holla, duke i kërcënuar të dëmtuarin V.K.-punëtor i kazinos dhe klientin e kazinos Sh.Th. Nga deklaratat e dhëna të akuzuarve në polici, në prezencë të avokatëve, në veçanti nga deklaratat e H.Sh. por edhe e N.B., të cilët pa kurrëfar presioni pas shikimit të video incizimeve, i akuzuari H.Sh.ka deklaruar se këtë grabitje me një besueshmëri prej 60% e ka kryer grupi i K.G., po ashtu edhe i akuzuari N. B. ka dhënë të njëjtën deklaratë, mirëpo deklaratat këtu para trupit gjykues por edhe në prokurori këta të akuzuar nga frika nga i akuzuari K.G.janë munduar që në ato pohime të mos deklarohen, është vërtetuar në tërësi se K.G. por edhe N. B. së bashku me S. M. dhe L.D. i ka ftuar në P... i akuzuari H.Sh. me të vetmin qëllim që të hyjnë në shtëpi të pabanuara nga personat ose të banuara nga personat që janë të shtyrë në moshë, me të vetmin qëllim që nga ato shtëpi të përvetësojnë në mënyrë të kundërligjshme të holla. N.B. ka deklaruar se dy herë ka qenë në P... dhe se bisedat që i ka zhvilluar me K.G., H.Sh., S.M. dhe L.D. kanë qenë përveç vjedhjes së shtëpive po ashtu edhe vjedhja e kazinos, ku në këtë drejtim ka deklaruar se K.G. ka qenë i armatosur, S.M. dhe L.D. kanë pas maskat dhe lidhëset, pra i kishin pajisjet për ta kryer këtë veprë dhe krejt këto pohime gjinden në shkresat e lëndës, andaj konsiderojmë se në veprimet K.G., H.Sh. N.B. dhe A.R. formohen të gjitha elementet e veprës penale të grabitjes në bashkëkryerje nga neni 329 par.3 lidhur me nenin 31 të KP-së, andaj i ka propozuar gjykatës që këta të akuzuar t’i shpall fajtor dhe t’i dënoj sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit K.G., av. R.H. në fjalën e tij përfundimtare të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se me asnjë provë nuk është vërtetuar se K.G.e ka kryer veprën penale të grabitjes e cila është kryer me datë 01.02.2015 në P... në kazinon “...” në bashkëkryerje me të akuzuarit tjerë si në aktakuzë. Edhe pse dëshmitë e bashkëakuzuarve nuk janë prova për fajësim dëshmitë e të akuzuarve në lidhje me të akuzuarin K.janë të qarta se K.G. nuk është kryes i veprës penale, kësajsoj N.B. në procesverbalin e datës 08.12.2016 në Prokurorinë Themelore në P...-Departamenti për Krime të Rënda, në pyetjen e prokurorit në lidhje me grabitjen e kazinos “...” ka deklaruar se “nuk kam njohuri”. I akuzuari H.Sh.në procesverbalin e datës 10.05.2016 ka deklaruar se deklarata e tij e dhënë në polici nuk është e vërtetë, pas kësaj edhe dëshmitari V.K. i cili është dëgjuar në gjykatë ka deklaruar se natën kritike i ka pa vetëm dy persona që janë larguar në drejtim të lagjes “...”. As përshkrimi personal të cilin e ka dhënë ky dëshmitar e as provat e tjera nuk e identifikojnë K.G. si pjesëmarrës i kryerjes në këtë veprë penale në kazinon “...”. Sa i përket foto dokumentacionit ka theksuar se vazhdon të qëndrojë pranë propozimit për kundërshtimin e provave, sepse këto prova nuk janë të pranueshme dhe si të tilla duhet të veçohen nga shkresat e lëndës. Prandaj, trupit gjykues i ka propozuar që në mungesë të provave ndaj të akuzuarit K.G.a.të merr aktgjykim lirues.

Mbrojtësja e të akuzuarit H.Sh., av. B.B.në fjalën e saj përfundimtare të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se fillimisht e kundërshton akuzën e Prokurorisë Themelore në P... PP.nr....të datës 31.03.2017 si dhe fjalën përfundimtare të prokurorit të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, ngase të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk kanë treguar dhe nuk e vërtetojnë se i mbrojturi H.Sh. ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Andaj ka kërkuar nga trupi gjykues që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të vendos sipas dispozitave ligjore dhe të marrë aktgjykim lirues.

Mbrojtësi i të akuzuarit N.B., av. B.N. në fjalën e saj përfundimtare të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se sa i përket aktakuzës nga e njëjta shihet se janë të akuzuar katër personal, ndërsa sa i përket provave materiale të cilat janë administruar si dhe deklarimin e dëshmitarëve është e qartë se bëhet fjalë për dy të tjerë e që sipas këtyre provave nuk ekzistojnë. Nëse bazohemi në provat materiale dhe në dëshmitë e dëshmitarëve okular mund të konkludojmë një të vërtetë se kanë qenë dy persona, një më i gjatë dhe një më i shkurtë të maskuar. Sa i përket identitetit të këtyre personave nga këto prova nuk mund të arrihet në asnjë konkludim. Përfaqësuesi i akuzës në fjalën përfundimtare pretendon se akuza është e vërtetuar nga se ekzistojnë deklaratat e vet të akuzuarve lidhur me veprimet e tyre, e në fakt në këtë modus ekziston një rrëshqitje nga lënda e akuzës, nga se të gjitha deklaratat të cilat pretendon të jenë provuese në fakt flasin për një ngjarje krejtësisht tjetër për të cilën ai ka kuptuar gjatë gjyqimit, e cila është gjykuar në këtë gjykatë dhe se këto deklaratat kanë të bëjnë me atë çështje e asesi me këtë. Pretendohet se i mbrojturi i tij në deklaratën e vet paska treguar lidhur me ngjarjen ashtu që përmendet një përqëndije e sigurisë së tij se një grup paska kryer këtë veprë penale, konstatim i cili natyrisht në procedurën penale absolutisht nuk lejohet, nga se parimi themelor i së drejtës penale është siguria e qind për qind nëse manipulohet me përqindje. Pra, në rastin konkret është e gabuar që dikush që ka kryer ndoshta ndonjë veprë penale të tipit të ngjajshëm për shkak të atij apo atyre veprave penale të akuzohet për një veprë penale për të cilën në tërësi mungojnë provat atëherë është një orientim i gabuar. Nga e

tëra i ka propozuar trupit gjykues që në rastin konkret të merr vendimin e vetëm të mundshëm, që është vendimi lirues.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.R., av.B.M. në fjalën e saj përfundimtare të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e kundërshton në tërësi akatukzën e paraqitur nga ana e prokurorisë së shtetit lidhur me të mbrojturin tim dhe të gjitha të thënat nga përfaqësuesi i akuzës të deklaruara në fjalën e tij përfundimtare.

Nga të gjitha provat materiale dhe deklaratat e dhëna gjatë shqyrtimeve gjyqësore i mbrojturi i tij A.R. është përmendur vetëm në një deklaratë të dhënë pranë prokurorisë së shtetit me datë 08.12.2016 nga i bashkakuzuari N.B., në të cilën ai kishte përmendur një A.R., po në këtë seancë prokurori i shtetit e kishte bërë identifikimin nëse A.R. i përmendur nga N.B. ishte i mbrojturi i tij apo ndonjë person tjetër, nga se N.B. gjatë identifikimit ka deklaruar se A.R. të cilin pretendon se e njeh nuk është A.R. i cili në këtë rast është në cilësinë e të akuzuarit. Asnjë provë tjetër qoftë nga video incizimet, foto dokumentacioni apo deklaratat nuk e përmend të mbrojturin tim A.R. me pretendimet se i njëjti ka kryer veprën penale. Meqenëse me asnjë provë apo deklaratë të ofruar nga prokuroria e shtetit nuk provohet asgjë për të mbrojturin tim A.R. i cili sot gjendet në sallë të gjyqimit konsideroj se do të ishte absurde të mundohem të provoj më tutje pafajësinë e tij, nga se kjo është e evidente. Rrjedhimisht në mungesë të provave të cilat në çfarëdo forme do ta provonin fajësinë e të mbrojturit tim, i ka propozuar trupit gjykues që ndaj të mbrojturi të tij A.R. të merr dhe shpall aktgjykim lirues.

Gjykata gjatë shqyrtimit gjyqësor ka administruar provat e propozuara dhe atë: është dëgjuar i dëmtuari në cilësi të dëshmitarit V.K., dëshmitari Sh.Th., si dhe është bërë shikimi në foto albumin e Drejtorisë Teknike të kriminalistikës të datës 20.02.2015 me nr. të rastit 2015-GA-... dhe një video incizim me nr. të rastit 2015-GA-...

I dëmtuari në cilësinë e dëshmitarit V.K. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se qëndron pranë deklaratave të dhëna më 10.05.2016 dhe më 31.03.2017 në prokurori dhe ka shtuar se në shkurt të vitit 2015 gjatë kohës sa ka qenë duke punuar në kazinon “...” me 01.02.2015 rreth orës 04:30-35min të mëngjesit dhe bashkë me të në lokal ka qenë edhe një klient i quajtur Sh.Th. i cili kishte qenë duke luajtur në aparat dhe në atë moment kanë hyrë dy persona të maskuar të cilët kanë qenë të veshur me rroba ngjyrë të zezë dhe kanë pasur edhe doreza. Në momentin kur ata kanë hyrë ai ka qenë duke qëndruar tek shanki dhe duke shikuar televizion dhe nuk është kthyer për ti shikuar pasi që ka menduar se janë klient. Më pastaj njëri nga ata personat që hynë në lokal kishte qëndruar te dera kurse tjetri kishte ardh afër tij dhe ia ka drejtuar armën në kokë dhe i kishte thënë ”shpejt paret”, meqë ishte i frikësuar atëherë ia kishte dhënë kuletën e tij ku kishte pasur 305 euro por këto të holla nuk kishin qenë të tij, ndërsa pasi i mori ato të holla shkoi tek klienti që ishte duke luajtur në aparat dhe ia drejtoi armën ku edhe atij i kërkoi para, njëjste sikurse ky edhe klienti Sh... ia kishte dhënë kuletën që e kishte pasur në xhep. Ka shtuar se ka pasur edhe para të tjera në banak por ato nuk i kanë marrë pasi që ata ishin larguar në momentin kur ia kishin marrë të hollat nga kuleta. Pasi ishin larguar nga lokali, në atë moment ky bashkë me klientin që ndodhej aty kishin dal jashtë dhe i kanë parë se ishin larguar në drejtim të rrugës që të dërgon në lagjen “...”. Sa i përket konstruksionit fizik ka theksuar se njëri ka qenë më i gjatë kurse tjetri më i shkurt ndërsa nuk ka mundur t’i identifikojë pasi që kanë pasur maska. Po ashtu ka deklaruar se e ka njoftuar policinë menjëherë kur kishin ik këta dy persona nga kazinoja dhe se për të

hollat që ia kanë marrë pra 305 euro meqë nuk kanë qenë të tij atëherë ka deklaruar se nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

Dëshmitari Sh.Th. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se më 01.02.2015 ka dhënë një deklaratë në polici lidhur me plaçkitjen që kishte ndodhur në kazinon “....., Më tej e ka përshkruar se si ka ndodhur rasti ditën kritike ku ka theksuar se rreth orës 4;30 min të mëngjesit, derisa ishte duke luajtur në kazinon “”, kanë hyrë nga dera hyrëse brenda në kazino dy persona të maskuar dhe të armatosur, ku njëri nga ta kishte shkuar në drejtim të punëtorit të kazinos ndërsa tjetri kishte ardhur te ai dhe ia drejtuar revolen në pjesën e pasme e kokës, e kishte detyruar që të shtrihej në dysheme pa e goditur dhe ia kishte kërkuar paratë. Në këtë mënyrë i dëmtuari ia kishte gjuajtur kuletën ku i kishte pasur 90 euro dhe pasi i kishte marrë të hollat atij i kishte kërkuar që të mos lëvizte nga ajo pozitë dhe ka vazhduar drejt punëtorit të kazinos, edhe këtij ia kishte marrë paratë. Sa i përket llojit të armëve ka deklaruar se kanë qenë armë të vogla dhe njëra ka qenë ngjyre e zezë kurse tjetra ngjyrë vizlluese, ndërsa sa i përket konstrukcionit fizik ka deklaruar se njëri ka qenë më i gjatë përafërsisht diku rreth 1:80cm, ka qenë i dobët ndërsa tjetri ka qenë më i shkurt, në duar kanë pasur dorëza dhe kanë qenë të veshur në pjesën e sipërme me tesha të zeza ndërsa poshtë me farmerka. Pasi i kishin marrë paratë me armët e drejtuar nga ky i dëmtuar dhe nga punëtori i kazinos, këta dy persona ishin larguar nga dera. Pasi kishin ikur këta dy persona, ai kishte vazhduar të qëndronte brenda në lokal ndërsa Veliu kishte dal deri te dera dhe e kishte njoftuar policinë. Në fund ka shtuar se kreyt kjo ngjarje sipas tij kishte zgjatur rreth 5 minuta.

Gjykata duke i analizuar dëshmitë e dëshmitarëve V.K. dhe Sh.Th.ka vërtetuar se ka ndodhur kjo grabitje me 01.02.2015 rreth orës 04:38 min në kazinon “...” nga dy persona të cilët kanë qenë të armatosur dhe njëherit të maskuar dhe në duar kishin pasur dorëza të zeza. Ndërsa nuk ka qenë e mundur të bëhet identifikimi i tyre si pasojë e maskave që i kishin në fytyrë.

Gjykata në shqyrtimin kryesor gjatë administrimit të provave ka administruar foto albumin e Drejtorisë Teknike të kriminalistikës të datës 20.02.2015 me nr. të rastit 2015-GA-..., ku nga shikimi në këtë foto album është vërtetuar se në kazinon “...” më 01.02.2015 rreth orës 05;34 kanë hyrë dy perona të cilët kanë qenë të maskuar dhe kanë qenë të armatosur.

Nga fotografitë e nxjerra nga kamera 2, është vërtetuar se rreth orës 05:43:38, njëri nga këta persona të maskuar dhe me armë në dorë i drejtohet punëtorit të kësaj kazino V.K. kurse personi tjetër që ishte i maskuar dhe me armë shihet duke shkuar në drejtim të klientit i cili në ato momente ndodhej në kazinon.

Ndërsa nga fotografia tjetër e nxjerrë nga po kjo kamer vërtetohet se në ora 05:44:20, ky person i maskuar që iu drejtua me armë punëtorit të kazinos tani largohet nga ai dhe duke u larguar atij i shihet vetëm pjesa e pasme e trupit.

Nga fotografitë e nxjerra nga kamera 3 është vërtetuar se në ora 05:43:03 se dy persona të maskuar dhe me kapela në kokë ngjiten shkallëve të kazions dhe hyjnë nga dera hyrëse e tij, saktësisht shihet njëri i cili e hap derën ndërsa tjetri duke e ndjekur nga pas. Ndërsa nga fotografia e nxjerrë nga po kjo kamer shihet se në ora 04:44:28 këta dy persona të cilët kishin hyrë në lokal tani tani nga kazinoja nga po ajo derë nga kishin hyrë dhe zbresin shkallëve njëri pas tjetrit, po ashtu në kokë vazhdojnë të mbajnë kapela.

Nga fotografitë e nxjerra nga kamera 4, kështu nga fotografia e parë shihet se në ora 05:43:17 shihet njëri nga grabitësit i maskuar, me kapelë në kokë, i cili ia drejton armën punëtorit të kësaj kazino këtu të dëmtuarit V.K.

Ndërsa nga fotografia tjetër shihet se në ora 05:43:34 se njëri nga grabitësit e mbanë armën të drejtuar kah punëtori i kazinos kurse tjetri shihet se kishte shkuar tek klienti i kazinos që ndodhej aty dhe nën kërcënimin e armës shihet se kërkon nga ai që të shtrihej për dysHEME.

Gjykata nga shiqimi në video incizim me nr. të rastit 2015-GA-..., shihet se në ora 05:43:03, dy persona të maskuar me kapela në kokë ngjiten shkallëve dhe hyjnë nga dera në kazinon "...", pasi hyjnë në kazino nxjerrin armët dhe njëri nga grabitësit shkon në drejtim të punëtorit të kazinos i cili në ato momente ishte duke shikuar televizion dhe nën kërcënimin e armës i kërkon të holla, punëtori shihet duke ia dhënë.... kurse grabitësit tjetër shkon në drejtim të klientit i cili në ato momente ndodhej në kazino duke luajtur në aparat dhe nën kërcënimin e armës kërkon nga ai që të shtrihet në tokë dhe po ashtu i kërkon para. ka ardhur në përfundim se fotografitë e mësipërme të administruara janë nxjerrë nga ky video incizim dhe si rrjedhojë gjykata nuk ka arritur që të vërtetojë nëse të akuzuarit kanë qenë kryes të kësaj veprë penale në bashkëkryerje.

Nga të gjitha këto fotografi të nxjerra nga këto kamera të cilat kanë qenë të vendosura në kazinon "..." gjykata ka arritur të vërtetoj gjatë kryerjes së kësaj grabitje kanë qenë dy persona të cilët kanë hyrë në kazino, njëri nga ta ishte më i gjatë kurse tjetri më i shkurt. Këta dy persona në duar kishin doreza ndërsa sa i përket veshjes ishin të veshur me rroba të zeza dhe në kokë kishin maska si dhe kapela, si pasojë e të cilave ka qenë e pamundur që të bëhet identifikimi i këtyre grabitësve. Pamundësisë së identifikimit të këtyre grabitësve i ka kontribuar edhe koha kur është kryer kjo veprë, ku ka qenë errësisë dhe pavarësisht faktit se këto fotografi janë zmadhuar, përsëri ka qenë e pamundur që të identifikohen grabitësit.

I akuzuari K.G. gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë me aktakuzë, ndërsa në mbrojtjen e tij ka deklaruar se e njeh H. Sh. përmes shokut të tij që quhet K.B., ndërsa N.B. e njeh që nga fëmërija dhe se me atë ka pasur një herë problem, po ashtu e njeh edhe A.R. që nga vitit 2014, me të cilin ishte takuar në K... ku kishte blerë një veturë nga ai, ka shtuar se ky i fundit është nga V.... Ka qëndruar pranë deklaratës së dhënë në prokurori me 17.03.2017, më tej ka shtuar se në P... ka ardh bashkë me K... në muajin shtator të vitit 2014 kur edhe e kanë sjellë H. Sh. i cili kishte qenë në F... te ata për vizitë, po ashtu në P...ka ardh edhe gjatë vitit 2015 bashkë me N.B. me veturë të tij, nuk i kujtohet nëse ka qenë Golf 2 apo Golf 3, nuk i kujtohet nëse ka qenë muaji shkurt apo mars, por ka ardhur pasi që e kishte thirr H. Sh. lidhur me rastin e vjedhjes për të cilin është gjykuar. Ka vazhduar të tregoj për rastin për të cilin është gjykuar, ku ka shtuar se pasi ishte takuar me H., ai e kishte detyruar për të hyrë në një shtëpi për të vjedh, kjo pasi që ai H. ia kishte një borxh në shumën prej 400 euro. Po ashtu ka shtuar se në Prizren nuk ka qenë në asnjë kazino. Në pyetjen e prokurorit se "në faqen e 3-të të deklaratës së dhënë në Prokurori, në pasuesin e parë në përgjigjen e tij ka deklaruar se "qëllimi i ardhjes në P... dhe biseda që keni zhvilluar me H.Sh. ka qenë për të vjedhur shtëpitë P..., ju në asnjë rast nuk e keni përmendur faktin se H.Sh. ia keni borxh 400 euro" pse vetëm gjatë seancës gjyqësore e ka deklaruar këtë fakt, i akuzuari është përgjigjur se ndoshta ka harruar që ta cek, si pasojë e faktit se askush nuk

e ka pyetur, ndërsa në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se në tërësi pajtohet me fjalën përfundimtare të dhënë nga mbrojtësi i tij dhe ka shtuar se fare nuk ka të bëjë me këtë rast.

Gjykata duke analizuar mbrojtjen e të akuzuarit K.G. fali besimin mbrojtjes së dhënë nga i akuzuari i cili ka pranuar se është njoftuar me H.Sh. përmes K.B., po ashtu e njëjti edhe N.B. dhe A.R., ky fakt u pohua edhe nga të akuzuarit e tjerë gjatë seancave gjyqësore. Më tej është e vërtetë se ai është gjykuar për rastin e vjedhjes që kishte ndodhur në shkurt të vitit 2015 në një shtëpi në P..., të cilën vjedhje e kishte kryer bashkë me dy të akuzuarit e tjerë, këtu H.Sh. dhe N.B.. Kurse sa i përket veprës penale të grabitjes që kishte ndodhur në kazino, për të cilën akuzohej i akuzuari K. gjykata nga deklaratat e tij si dhe nga provat e tjera të administruara nuk ka mundur ta vërtetojë nëse njëri nga kryesit e kësaj vepre penale ka qenë i akuzuari K.G.

I akuzuari H.Sh. gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë me aktakuzë, ndërsa në mbrojtjen e vet ka deklaruar se K.G. dhe N.B. i njëjti nga rasti i kaluar për të cilin është dënua dhe se me ta është takuar dy herë gjatë vitit 2015 dhe më nuk është takuar. Takim ky i cili është zhvilluar për rregullimin e një pasaporte në S... për K. dhe pas një jave e kishin lënë përsëri të takoheshin në të njëjtin vend në P..., ku në këtë takim ai i kishte treguar K. se nuk ka mundësi të rregullohej ajo pasaportë pasi që komuna e P... dhe ajo e F... po dallojnë në S...dhe më pas kishte ndodhur edhe vjedhja në një shtëpi. Kurse sa i përket A.R. ka deklaruar nuk e njeh për herë të parë e ka takuar në gjykatë. Ka shtuar se lidhur me këtë rast për të cilin akuzohet, pra për veprën penale të grabitjes, ka dhënë deklaratë në polici më 08.05.2015 rreth orës 13:30 në prezencë të avokatit R.K., ku figuron nënshkrimi i këtij të fundit në secilën faqe të deklaratës, por i akuzuari ka deklaruar se avokati i lartcekur ka qenë prezent vetëm pesë minuta dhe jo gjatë gjithë kohës sa e ka dhënë deklaratën. Gjatë kohës sa e ka dhënë këtë deklaratë nuk ka pasur kurrfarë presioni nga policët hetues të cilët e kishin njoftuar për deklaratën e N.B. se si kishte ndodh ky rast dhe se i nevojitej edhe ndihma e këtij për ta zbardh rastin. Po ashtu ai kishte dhënë një deklaratë edhe në prokurori më 10.05.2016 në prezencën e mbrojtësit të tij dhe se qëndron pranë kësaj deklarate të dhënë ndërsa në pyetjen e prokurorit “në faqen e 3-të të deklaratës së dhënë para Prokurorit të Shtetit, në pasuesin e parë në rreshtin e nëntë kishte theksuar se “ unë e kam ndier veten të kërcënuar, pasi K.G.ka qenë i armatosur” është përgjigjur se K.G. ka qenë i armatosur edhe pse mua nuk më ka kërcënuar unë e kam ndier veten të kërcënuar. Ndërsa pas shikimit të video incizimit dhe foto dokumentacionit në polici lidhur me grabitjen në kazinon “...” në B... ka theksuar se është diku rreth 60% i sigurt se njëri prej këtyre dy personave që kanë hyrë në kazino me armë është K. G. ka theksuar se kjo pjesë e deklaratës është e N.B. e cila është paraqitur në polici dhe se me këtë pjesë të deklaratës është njoftuar në prokurori madje ka kërkuar sqarim nga prokuroria se pse kjo pjesë e deklaratës së N. i ishte shtuar edhe deklaratës së tij kur ai nuk kishte deklaruar ashtu sepse nuk ishte ekspert për ta konstatuar një gjë të tillë, aq më tepër kur nuk ka mundur ta vërej se kush ka qenë. Në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se në tërësi pajtohet me fjalën përfundimtare të dhënë nga mbrojtësi i tij dhe ka shtuar se në deklaratën e dhënë nga i akuzuari N.B. lidhur me faktin se është takuar me mua, ky takim ka ndodhur për rastin për të cilin është gjykuar nga kjo gjykatë dhe se më nuk është takuar me N.B.

Duke analizuar mbrojtjen e të akuzuarit H.Sh. gjykata ia fali besimin edhe këtij të akuzuari sa i përket faktit se i njeh K.G. dhe N.B. dhe se me këta në bashkëkryerja e ka kryer veprën penale të vjedhjes për të cilën vepër edhe janë gjykuar. Besimin nuk ja fali kur ka deklaruar se pjesën më të madhe të deklaratës në polici e ka dhënë pa prezencën e avokatit, edhe pse në çdo faqe të deklaratës së tij figuron nënshkrimi i avokatit, pasi që nuk ka mundësi që pa u dhënë deklarata në tërësi ajo të nënshkruhet paraprakisht, pra kjo nënkupton se avokati ka qenë prezent deri në fund të marrjes së deklaratës së të akuzuarit në polici, kjo konfirmohet edhe nga nënshkrimi i cili ndodhet në faqet e deklaratës, në të kundërtën si pasojë e mos prezencës ai nënshkrim do të mungonte si dhe këtë e vërteton fuqishëm edhe konstatimi i bërë në fund të deklaratës së dhënë në polici nga ai akuzuari i cili ka deklaruar se deklarata e ka dhënë në prezencë të avokatit të tij R.K.. Po ashtu nuk qëndron edhe deklarimi i tij se deklarata e tij të dhënë në prokurori i ishte shtuar pjesa “se 60% i sigurt se njëri prej këtyre dy personave që kanë hyrë në kazino me armë është K.G.”, për të cilën pretendonte se ishte pjesë e deklaratës të akuzuarit N.B. të cilën e kishte dhënë në polici, gjykata pasi e shikoi deklarata në polici ka kontaktuar se ky fakt nuk qëndron dhe se deklarata e tij nuk i ishte shtuar asgjë, pasi që ai vet në polici kishte deklaruar se 60% i sigurt se njëri prej këtyre dy personave që kanë hyrë në kazino me armë është K.G. ndërsa në deklarata e N.B. nuk haset një deklarami i tillë. Si përfundim duke e analizuar mbrojtjen e këtij të akuzuari si dhe provat e administruara gjykata nuk arriti të vërtetojë nëse i akuzuari e ka kryer këtë vepër penale të grabitjes në bashkëkryerje në kazinon “...” apo i ka kontribuar kryerjes së saj me ndonjë veprim.

I akuzuari N.B. gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë me aktakuzë, ndërsa në mbrojtjen e tij ka deklaruar se mbetet pranë deklaramëve të dhëna në prokurori dhe se më tepër nuk dëshiron që të deklarohet, ndërsa në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se në tërësi pajtohet me fjalën përfundimtare të dhënë nga mbrojtësi i tij.

I akuzuari A.R. gjatë shqyrtimit gjyqësor, nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë me aktakuzë, ndërsa në mbrojtjen e tij ka deklaruar se nuk ka qenë prezent kur është kryer kjo grabitje dhe se është ftuar në prokurori që të identifikohet nga i akuzuari N.B., i cili gjatë identifikimit ka deklaruar se A.R. nuk është këtu i akuzuari A.R., sepse A.R. tjetër është më i gjatë dhe ka flokë të bardha. Po ashtu ka pohuar se ka dhënë një deklarata në polici më 27.05.2015 në prezencë të avokatit I.G. si dhe në prokurori më 08.12.2016 dhe ka deklaruar se nuk qëndron pranë deklaratës së dhënë në prokurori pasi që në atë deklarata sipas prokurorit thuhet se kam deklaruar se kam qenë në paraburgim me S.M. dhe L.D., thënie kjo e cila nuk qëndron, pasi që e di se unë nuk kam deklaruar para prokurorit se kam qenë në paraburgim me këta dy persona. Ka shtuar se S.M. dhe L.D. i njeh pasi që kanë punuar bashkë në restorant “...” në K..., ndërsa e njeh edhe K.G. cili në këtë restorant ka ardh si mysafir, kurse sa i përket të akuzuarit H. Sh. ka deklaruar se nuk e njeh dhe se nuk e ka parë asnjëherë përveçse në gjykatë që e ka parë gjatë seancave gjyqësore. Ndërsa në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se në tërësi pajtohet me fjalën përfundimtare të dhënë nga mbrojtësi i tij.

Gjykata mbrojtjes të akuzuarit A.R., ia fali besimin në drejtim të mos prezencës së tij gjatë kohës kur është kryer vepra penale e grabitjes, ndërsa nuk ia fali besimi kur ka mohuar se në prokurori në deklarata e tij, ka deklaruar se ka qenë në paraburgim me S.



M. dhe L.D., pasi në deklaratën e tij që e ka dhënë në prokurori, saktësisht në faqen e dytë, paragrafi i fundit, në përgjigjen e tij ka deklaruar se me K.G., S.M. dhe L.D. se i njeh por jo aq mire, pasi me këta ka qenë në paraburgim dhe se kjo deklaratë e tij është e nënshkruar në secilën faqe, nëse një gjë e tillë nuk qëndron atëherë i akuzuari nuk ka qenë i obliguar ta nënshkruaj këtë deklaratë, madje ka pasur mundësi që para nënshkrimit ta lexoj dhe njëherit t'i kundërshtoj ato pjesë të deklaratës për të cilat ka pretenduar se ai nuk i ka thënë. Më tej, nuk është kontestuese se e njeh K.G., pasi që edhe ky i fundit në deklaratën e tij kishte deklaruar se e njeh A.R., ndërsa është vërtetuar se të akuzuarin H. Sh. nuk e njeh, në të njëjtën mënyrë kishte deklaruar edhe H.Sh. për atë. Kështu nga kjo deklaratë e të akuzuarit A.R. e ndërlidhur me provat e tjera të administruara gjykata nuk ka arritur që të vërtetojë se i akuzuari e ka kryer veprën penale të grabitjes në bashkëkryerje me të akuzuarit e tjerë.

Gjykata, pas vlerësimit të provave materiale lart theksuara, dhe pas analizimit të secilës provë veç e veç dhe të ndërlidhura në tërësi, dhe të gjitha së bashku, konstatoi se me asnjë provë nuk është vërtetuar se të akuzuarit në bashkëkryerje e kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen nga ana e prokurorit të shtetit, respektivisht veprën penale të grabitjes në bashkëkryerje nga neni 329 par 3 lidhur me nenin 31 të KP-së.

Në rastin konkret gjykata ka ardh në përfundim se nuk është kontestuese se me datën 01.02.2015, në kazinon “...” e cila gjendet në rrugën “...” në P... është kryer një grabitje me armë nga dy persona të maskuar të cilët atë natë rreth orës 04;38 minuta nën përdorimin e forcës dhe armës duke e kanosur të dëmtuarit Sh.Th.dhe V. K. iu marrin të hollat dhe atë nga Sh.Th. shumën prej 305euro ndërsa nga V.K. në shumën prej 69 euro dhe pastaj dalin nga kazinoja dhe ikin në drejtim të panjohur. Gjithashtu nuk është kontestuese se në këtë grabitje kanë marrë pjesë vetëm dy persona të cilët kanë qenë të maskuar për çka edhe që të dy të dëmtuarit nuk kanë mundur t'i identifikojnë pasi që ishin të maskuar, gjithashtu nuk është kontestuese se me rastin e grabitjes është përdorur arma por se arma nuk është gjetur. Aktakuza në përshkrimin faktik i ngarkon të akuzuarit se “K.G.dhe A.R. bëjnë roje në hyrje të lokalit ndërsa N. B. dhe H.Sh. hyjnë brenda në kazino”, ndërsa nga video inçizimi rezulton se në rastin konkret në grabitje kanë marrë pjesë vetëm dy persona të maskuar të cilët në kokë kishin të vendosur kapela, të cilët nga kamera e kazinos që ishte e vendosur jashtë kazinos shihen këta persona të maskuar të cilët futen në kazino, e që nga kamerat brenda kazinos shihen po ata dy persona të cilët e kryejnë grabitjen dhe dalin nga kazinoja, e që më pastaj po nga kamera që ishte jashtë kazinos shihen të njëjtit persona që e kanë kryer grabitjen që largohen në drejtim të panjohur, pra shihen vetëm dy persona të maskuar dhe asnjë person tjetër, pra nuk kanë qenë katër persona ashtu siç e përshkruan aktakuza. Nga i gjithë video incizimi i shikuar, gjykata nuk ka mundur të vërtetojë se dy personat të cilët kanë kryer grabitjen kanë qenë ndonjëri nga të akuzuarit, fakt ky i cili është vërtetuar edhe nga deklaratat e të dy të dëmtuarve të cilët nuk kanë mundur që t'i identifikojnë personat që e kanë kryer grabitjen.

Andaj duke u bazuar në të lart – theksuarat dhe provat të cilat u administruan në këtë çështje gjyqësore, gjykata nuk ka provuar se të akuzuarit K.G. H.Sh., N.B. dhe A.R. kanë kryer veprën penale që iu vihet në barrë me aktakuzë, prandaj të njëjtit i liroi nga akuza.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë në kuptim të nenit 454 paragrafi 1 të KPP-së.

Nga të cekurat si më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**-Departamenti për Krime të Rënda-**  
**P. nr.38/17 të datës 17.10.2017**

Procesmbajtësja,  
Birsen Kume

Kryetari i trupit gjykues,  
Skender Çoçaj

**UDHËZIM JURIDIK:** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në afat prej 15 ditëve, pas marrjes së të njëjtit – Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.